

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA NË VITI**, Departamenti i përgjithshëm si gjykatë penale e shkallës së parë, duke vendosur sipas gjyqtarit Xhavit Haziri me Sek. Juridike Naime Ibishi , në çështjen penale kundër të akuzuarve F. T. dhe B. T. nga K,Ferizaj me qka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,sipas aktakuzës PP.II.nr 1002/2016 të datës 06.06.2016.Pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me daten 08.03.2017, me datën 10.03.2017 pa prezencën e palëve morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I

I akuzuari F. T nga babai X dhe nëna N e vajzërisë N, data e lindjes ...i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën ... me gjendje te mesme ekonomike, kombesia xx, shtetas i R,Kosoves

#### II

I akuzuari B T nga babai X dhe nëna N e vajzërisë N, data e lindjes ...i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën ... me gjendje te mesme ekonomike, kombesia xx, shtetas i R,Kosoves

### J A N Ë F A J T O R

Sepse gjat muajit shtator të vitit 2015, në interval të pa percaktuar kohor, në fshatin Ramjan të komunës së Vitis, me qëllim të përfitimit të kunderligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, të pa ndehurit F.T dhe B.T, në bashkëveprim me dashje kanë kryer vjedhje të rëndë në dëmtë të dëmtuarit M. Z., në atë mënyrë që me përdorimin e forcës e kanë nxjerr nga vendi deren e hyrjes se objektit-puntorisë, kanë hyrë brenda dhe kanë vjedhur 30 copë dërrasa industriale për ndërtim,të dimenzioneve 200x50mm si dhe deren e hyrjes nga metali me dimenzion 2x1 m, dhe trashësi rreth 4 mm, me që rast të pa ndehurit me veprimet e tyre, të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material në vlerë të pa percaktuar

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në këto dispozita ligjore të nenit 7, 17, 21, 41, e 45, 46, të KPRK-ës si dhe nenit 360, 361, dhe 365 të KPPRK-ës.

## I G J Y K O N

### I

I akuzuari F. T.dënohet me dënim gjobë ne shumën prej 500 (pesqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj,në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi e në rast mospagesës i njejt i dënim do t'i zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **25** ditësh , duke u llogaritur çdo ditë të kaluar në burg nga 20 euro.si dhe denim me **burg në kohëzgjatje prej 90 ditësh, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta vuaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi.**

### II

I akuzuari B. T. dënohet me dënim gjobë ne shumën prej 500 (pesqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj,në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi e në rast mospagesës i njejt i dënim do t'i zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **25** ditësh , duke u llogaritur çdo ditë të kaluar në burg nga 20 euro.si dhe denim me **burg në kohëzgjatje prej 90 ditësh, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta vuaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi.**

I dëmtuari M. Z. për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore ne shumen prej 30 euro, gjithashtu në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit nga Gjilani me datën 06.06.2016, ka ngritur aktakuzën PP. nr. 1002/2016 kundër të akuzuarve F. T.dhe B. T.,nga Ferizajit për shkak të veprës vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Ismet Ukshini deklaroi:se mbetet në tërsi pranë aktakuzës së paraqitur dhe propozimeve që e njëjta i përmban pasi që gjendje faktike në këtë qështje penalo juridike u vërtetua me pranimin e fajësisë nga ana e të pa ndehurve, pranim ky që ishte në përputhshmëri me provat që kjo prokurori i kishte propozuar për ti shtjelluar për vertetimin e drejtë të pretendimeve të aktakuzës.Andaj i propozon gjykatës që të njejt i ti shpallë fajtorë dhe ndaj të nejtëve tia shqipton sanksionet dhe masat e parapara ligjore duke marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësues. Si rrethanë lehtësuese gjykata të merr parasysh se të panduhurit ishin korrekt, kishin sjellje të mira dhe vullnetarisht pa kurfar ndikimi apo presioni pranuan fajësinë për veprën penale që aktakuza ua vë në barrë.

I akuzuari F.T në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës ka kërkuar të merren parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, i ka propozuar gjykatës që t'i shqipton një dënim

ma të butë, duke pasur parasysh gjendjen e varfër ekonomike, pendohet për veprën të cilën e ka kryer dhe një vepër të tillë nuk do ta përsërisë asnjëher.

I akuzuari B. T. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës ka kërkuar të merren parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, i ka propozuar gjykatës që t'i shqipton një dënim ma të butë, duke pasur parasysh gjendjen e varfër ekonomike, pendohet për veprën të cilën e ka kryer dhe një vepër të tillë nuk do ta përsërisë asnjëher.

Në shqyrtimin fillestar të akuzuarit në tërsi e kanë pranuar fajësinë sipas dispozitivit të aktakuzës. Gjykata ka qenë e bindur se të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuari dhe pranimi i fajësisë është mbështetur në faktet që përmban aktakuza, në provat e prezentuara nga prokuroria të cilat kanë qenë të pranuar nga të akuzuarit. Duke vlerësuar pranimin e fajësisë së të akuzuarve, gjykata fare nuk i shtjelloi provat ngase gjendja faktike në këtë qështje penale nuk ishte kontestuese, të akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë bërë duke mos kontestuar asnjë fakt nga dispozitivi i aktakuzës.

Pra një gjendje të këtillë faktike të pa kontestuar gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet e veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata për të pa ndehurin F.T morri parasysh, sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhem nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata për të pandehurin B.T. morri parasysh, sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhem nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore.

Për këtë arsye i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky dënim do të ndikoi pozitivisht tek i akuzuari për mos përsëritje të veprave të tjera penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndërsa vendimi mbi kërkesën pasurore juridike konfomr nenit 463 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA NË VITI**  
**P.nr. 318/2016**  
**Me 08.03.2017**

**Sek. Juridike,**  
**Naime Ibishi**

**Gj y q t a r i,**  
**Xhavit Haziri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykim mundë të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.